

Çfarë është ELI?

ELI (European Legislation Identifier) është një sistem për ta bërë legjislacionin e cdo vendi, të vlefshëm për aksesim online në një format të standardizuar, me qëllim që ai të mund të aksesohet, të shkëmbehet dhe ripërdoret pa kufij vendesh apo sistemesh. Kjo iniciativë e ndërmarrë në mënyrë të përbashket nga vendet dhe institucionet e BE, është e sanksionuar në [Council Conclusions](#) me 6 Nentor 2017, në "European Legislation Identifier "(2017/C 441/05).

ELI bazohet në një marrëveshje vullnetare mes vendeve të BE. Ai përfshin specifikime teknike mbi:

- **Identifikuesit Web (web unified resource identifiers)** (URIs) për informacionin ligjor
- **Metadata**, duke përcaktuar pershkrimin e informacionit ligjor përmes një set metadatash të unifikuara për të gjitha shtetet dhe të lexueshme nga makinat
- Një gjuhë specifike për **shkëmbimin e legjislacionit** në formate të lexueshëm RDF nga sistemet informatike/makinat, përmes rreshtimit të metadatave sipas një standardi.

ELI është themeluar dhe sponsorizohet në kuader të [Action "Facilitating the exchange of legislation data in Europe"](#), që kuadrohet në Programin e Zgjidhjeve të Interoperabilitetit për administratën Publike Europiane ([ISA](#)).

Qëllimi i ELI

Mbështetja për lehtësimin e aksesit, shpërndarjes dhe interoperabilitetit të informacionit ligjor të publikuar në sistemet informatike kombëtare të vendeve të Europës dhe jo vetëm, dhe informacionit ligjor në kontekstin e BE. Fokusi i vecantë është në lehtësimin e kërkimit, shkëmbimit dhe interkoneksionit të informacionit ligjor mes sistemeve kombëtare dhe atyre Europiane. Ndërkohë vetë ELI merr parasysh gjithmonë përmirësimin e kuadrit teknik dhe konsultativ duke iu përgjigjur specifikave të vecanta të cdo vendi të BE apo evropjan jashtë BE.

Përfitimet nga implementimi i ELI

- Akses në legjislacion kombëtar, ndërkombëtar dhe atë të BE
- Zhvillimi i shërbimeve të reja që kanë në bazë përdorimin e pakufizuar që lejon publikimi i legjislacionit sipas ELI
- Ulja e kostove të publikimit
- Cilësia dhe siguria e publikimit
- Interoperabiliteti legjislativ
- Transparenca